



BIBLIOTEKA UAMD PLANI STRATEGJIK 2025-2030

Përgatitur nga Venera Alliaj



1. Misioni

Biblioteka Universitare e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës është qendra kryesore e informacionit akademik dhe kërkimit shkencor. Misioni i saj është të sigurojë akses të plotë, të barabartë dhe bashkëkohor në burime informacioni, duke mbështetur procesin mësimor dhe kërkimor në përputhje me standardet ndërkombëtare të bibliotekave akademike.

2. Vizioni

Të jetë një bibliotekë moderne, digjitale dhe inovative, që kontribuon në zhvillimin e dijes dhe kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

3. Vlerat Themelore

- Cilësi dhe saktësi në ofrimin e informacionit
- Qasje e hapur dhe gjithëpërfshirëse
- Inovacion dhe teknologji
- Bashkëpunim dhe rrjetëzim akademik
- Integritet profesional

Qëllimi 1: Modernizimi i infrastrukturës dhe mjediseve të leximit

- Ndërtimi i godinës së re të bibliotekës
- Rikonstruksioni i sallave të leximit dhe zonave të studimit. Shtimi i tyre.
- Krijimi i hapësirave bashkëpunuese për studentët dhe studiuesit.
- Krijimi i një zone multimedia për studio, prezantime dhe praktikë digjitale.
- Investime në teknologji: kompjuterë, skanera profesionalë, printera 3D.



Qëllimi 2: Digjitalizimi dhe zhvillimi i bibliotekës elektronike

- Skanimi dhe digjitalizimi i koleksioneve të veçanta (literatura gri). Krijimi i arkivit digjital institucional.
- Integrimi me sistemin COBISS dhe platformat ndërkombëtare.
- Aksese të vazhdueshme në burime elektronike



Qëllimi 3: Zhvillimi i koleksioneve dhe menaxhimi i informacionit

- Përditësimi i koleksioneve në përputhje me programet studimore.
- Hartimi i politikave të zhvillimit të koleksioneve.

Synimet 5-vjeçare

- Dyfishim i pjesëmarrjes së komunitetit në programet, aktivitetet, workshop-et e organizuara nga biblioteka
- 30% rritje të përdorimit të hapësirave të bibliotekës
- 30% rritje të përdorimit të koleksioneve të bibliotekës

Qëllimi 4: Rritja e kompetencave të stafit bibliotekar

- Trajnime për menaxhim informacioni dhe teknologji bibliotekare.
- Pjesëmarrje në konferenca dhe rrjete profesionale.
- Krijimi i programeve të zhvillimit profesional.

Qëllimi 5: Promovimi dhe përfshirja e komunitetit akademik

- Organizim aktiviteteve kulturore dhe trajnimesh për përdoruesit.
- Fushata ndërgjegjësimi për shërbimet bibliotekare.
- Bashkëpunim me fakultetet dhe qendrat kërkimore.
- Forcimi i bashkëpunimit dhe kërkimit shumëdisiplinor
- Zhvillimi i partneriteteve afatgjata kërkimore duke iu dhënë përparësi trajnimeve, workshop-eve, konsultave, etj.
- Forcimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies

Qëllimi 6: Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërkombëtar

- Nënshkrimi i marrëveshjeve me biblioteka dhe institucione të tjera.
- Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare (Erasmus+, Horizon Europe).
- Forcimi i mbështetjes për të rritur impaktin institucional dhe vizibilitetin

Synimet 5-vjeçare

- Rishikimi vjetor i koleksioneve
- Krijimi i një seksioni të posaçëm kërkimor për punimet shkencore të stafit të UAMD.
- Rritja e abonimeve në databaza ndërkombëtare dhe akses open-access.

5. Vlerësimi dhe Monitorimi

Zbatimi i planit strategjik do të monitorohet çdo vit përmes raporteve të progresit dhe indikatorëve të matshëm të performancës. Rishikimi do të bëhet çdo dy vjet për përshtatje me zhvillimet teknologjike dhe akademike.

Synimet 5-vjeçare

- . Rritja e numrit të përdoruesve në mundësitë e të mësuarit që ofron biblioteka
- . Rritja e vizibilitetit të hulumtimeve individuale apo në rang fakulteti

6. Burimet e Nevojshme

- Financim nga buxheti i universitetit dhe donacione
- Partneritete me institucione të huaja
- Mbështetje teknologjike dhe logjistike nga strukturat përkatëse

7. Përfundime

Ky plan strategjik për periudhën 2025–2030 synon të transformojë Bibliotekën e Universitetit “Aleksandër Moisiu” në një qendër moderne, digjitale dhe inovative, që mbështet zhvillimin akademik dhe kërkimin shkencor në përputhje me misionin e universitetit.